



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 20.11.2020)*

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 7. Ilir Toska*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj*** (anëtar)

*10. Marçela Shehu* (anëtare)

*11. Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Përshëndetje!

Marrin pjesë të gjithë anëtarët.

Po fillojmë mbledhjen e radhës të datës 20 nëntor, e cila ishte parashikuar të zhvillohej ditën e djeshme më datë 19.11.2020, por siç e shpjegova edhe dje, për shkak të pamundësisë nga ana teknike, u shty që të zhvillohet ditën e sotshme.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës sot janë 13 çështje. Është përfshirë edhe një çështje urgjente e përcjellë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Konkretisht janë: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Është shqyrtimi i katër projektvendimeve të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për sa i përket rihapjes së procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, për katër pozicione.

Shqyrtimi i tre projektvendimeve të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar, për tre pozicione.

Më pas kemi shqyrtimin e projektvendimit për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale.

Kemi më pas shqyrtimin e projektvendimit për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile.

Më tej kemi shqyrtimin e projektvendimit për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit.

Më pas kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtarës {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Më tej kemi shqyrtimin e projektvendimit për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative.

Më tej kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020.

Më tej kemi shqyrtimin e projektvendimit për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative.

Më tej kemi shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për emërimin e përkohshëm të 9 ndihmësve ligjorë në pozicionet e Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Korçë.

Më pas kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor në gjykatat e apelit”.

Dhe së fundi kemi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet.

Çështja e fundit ka të bëjë me ushtrimin e të drejtës së rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

Këto janë çështjet që kemi në shqyrtim sot.

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim.

**Brunilda Kadi:** Kryetare, kam unë diçka për rendin e ditës.

**Naureda Llagami:** Po, zonja Kadi!

**Brunilda Kadi:** Unë kërkoj që të futet në rendin e ditës ajo pika që u hoq sipas njoftimit që na bëri Drejtori Juridik, me e-mail, që ishte futur aksidentalisht (nuk e di, kështu ishte shpjegimi). Nuk mendoj që ka ndonjë arsye pse të mos vijojmë edhe me atë rend dite sepse relacionet janë dërguar dhe besoj që i plotëson të gjitha kushtet për të vijuar edhe sot.

**Naureda Llagami:** Sikurse jua kam dhënë edhe shpjegimin, për dy çështje të rendit të ditës, nuk bëhet fjalë vetëm për atë, por edhe për çështjen e procesverbaleve, janë hequr nga rendi i ditës për shkak se janë vënë gabimisht nga stafi administrativ, pa u konsultuar me mua dhe për këtë arsye, sikurse jua shpjegova, do kalojnë për mbledhjen tjetër të ardhshme. Nëse nga ju anëtarët e Këshillit gjykohet dhe vlerësohet që të përfshihet në këtë mbledhje, okej, le ta votojmë dhe le ta vendosim për ta përfshirë në mbledhje.

**Brunilda Kadi:** Atëherë, unë nuk mendoj që ky shkak mund të shërbejë si arsyetim as logjik as ligjor, që të mos përfshihet kjo në rendin e ditës, në qoftë se është

një gabim nga stafi administrativ (edhe sikur të jetë kështu siç e thoni juve). Kështu që unë kërkoj që të hidhet në votë përfshirja në rendin e ditës e pikës për hapjen e vendeve vakante në Gjykatën e Lartë, për tre pozicionet.

Për sa i përket procesverbaleve mendoj që le të futen edhe ato. Unë s'kam problem.

Por në fillim kërkoj që të futet hapja e vendeve të Gjykatës së Lartë dhe të hidhet në votim.

**Naureda Llagami:** Patjetër, le të hidhet në votim.

Këtë thashë, Bruna.

**Marçela Shehu:** Kisha vetëm diçka.

Ne si Komision, mendoj unë, ose edhe për mua si anëtare e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, nuk ka ndonjë problem nëse çështja përfshihet edhe sot në rendin e ditës. Por në qoftë se ndonjë nga anëtarët nuk është gati që kjo çështje të trajtohet sot, atëherë mendoj që, bazuar vetëm në mendimin e një prej anëtarëve, mund të mos përfshihet në rendin e ditës.

Pra përpara se të hidhet në votim, do doja që anëtarët të shpreheshin nëse janë njohur me materialet dhe nëse janë gati që të përfshihet sot apo jo.

**Naureda Llagami:** Po, Ilir!

**Ilir Toska:** Atëherë, mendoj që ta përfshijmë në rendin e ardhshëm të mbledhjes plenare të Këshillit, pasi do të kemi edhe një situatë, një ngërç që do duhet ta konsiderojmë në momentin e shpalljes së atyre vendeve, kjo sa i përket zbatimit të pikës 6, të nenit 48 të ligjit për Statusin. Nga njoftimet që ne bëjmë kemi evidentuar edhe qëndrimin tonë, ndërkohë aktualisht kemi dy vendime të Gjykatës Administrative të Apelit që kanë mbajtur qëndrime të ndryshme sa i përket interpretimit dhe zbatimit të kësaj norme ligjore.

Në këto kushte, në ditën e sotme kemi edhe një çështje të kësaj natyre e cila është ajo që ka të bëjë me ushtrimin e të drejtës së rekursit ndaj një vendimi të Gjykatës Administrative të Apelit, dhe është një problem që ne do duhet ta konsiderojmë, qoftë

edhe momentin e shpalljes, duke i bërë të ditur kandidatëve qëndrimin e Këshillit dhe mundësinë e tyre për kandidim. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

**Brunilda Kadi:** Kryetare, mundem?

Në lidhje me këtë që thotë zoti Toska, nuk mendoj që kjo situatë do zgjidhet deri javës tjetër sepse në qoftë se ne do presim vendimin e Gjykatës së Lartë, besoj jemi të gjithë koshient që kjo s'mund të ndodhi javës tjetër sepse ne duhet të bëjmë rekursin njëherë në qoftë se e miratojmë, kështu që nuk mendoj që zgjidhet deri javës tjetër. Nuk mendoj se mund të presin këto vende derisa të vendosë Gjykata e Lartë. Ne hapim vendet, shpallim afatin brenda të cilës kohë duhet të kandidojnë gjyqtarët dhe pastaj këto diskutimet, logjikisht, ligjërish kanë vend të bëhen më pas. Kështu që unë i qëndroj propozimit që të futet në rend dite.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në votim, nëse ka ndonjë diskutim tjetër nga kolegët. Kalojmë në votim në futjen në rend të ditës të kësaj pike.

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Illir Toska:** Kundër.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Kundër.

**Marçela Shehu:** Dakord, për sa kohë unë jam e njohur me materialin dhe jam e gatshme që të përfshihet në çdo kohë në rendin e ditës. Kështu që edhe sot, nëse të gjithë anëtarët janë njohur dhe janë gati, jam dakord që të përfshihet në rendin e ditës.

**Erjon Muharremaj:** Kundër.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Kundër.

Propozimi për t'u futur në rend dite rrëzohet.

Kalojmë në çështjen e parë, sipas rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020”.

Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Krahas projektvendimit, ju është dërguar edhe relacioni shpjegues lidhur me këtë projektvendim. Shkurtimisht mund t’ju them se Këshilli i Lartë Gjyqësor, në ushtrim të përgjegjësive të tij sa i përket promovimit të gjyqtarëve të ngritjes në detyrë, me qëllim plotësimin e pozicioneve të lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndër të tjera miratoi edhe Vendimin nr.91, datë 26.02.2020, për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në këtë gjykatë, për një pozicion të lirë.

Brenda afatit të kandidimit në këtë procedurë ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat ky që ka përfunduar më 20.05.2020, kandiduan 3 gjyqtarë: {...} – {...}.

Lidhur me kandidimin e znj.{...} është konstatuar se ajo, përveç pozicionit të lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr.91, datë 26.02.2020, ka aplikuar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar edhe për tre pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 88, nr. 89 dhe nr.90, datë 26.02.2020, sikundër edhe për pozicionin e shpallur me Vendimin e Këshillit nr.92, datë 26.02.2020.

Gjatë shqyrtimit të projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 90, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, mbasi diskutoi mbi interpretimin dhe

zbatimin e pikës 6, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, Këshilli konsideroi të ftonte znj. {...} për të përcaktuar në mënyrë të qartë pozicionin e tretë për të cilin kandidonte për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërsa kishte konsideruar më herët aplikimet e saj për dy pozicionet e para të lira, ato të shpallura me Vendimet e tij nr. 88 dhe nr. 89, datë 26.02.2020.

Në përgjigje të kësaj ftese të Këshillit, në rrugë elektronike, znj. {...} përcaktoi pozicionin e tretë për të cilin kandidonte për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pikërisht atë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 90, datë 26.02.2020.

Marrë shkas nga përgjigja e znj. {...}, në kushtet kur ajo përcaktoi në mënyrë të qartë tre pozicione të lira për të cilat do të vijonte kandidimin për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke hequr dorë indirekt nga kandidimet për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 91 dhe nr. 92, datë 26.02.2020, znj. {...} nuk u përfshi në listat e kandidatëve për këto dy pozicione, pra edhe për atë të shpallur me Vendimin nr.91, datë 26.02.2020.

Mbi këtë bazë, me Vendimin nr.191, datë 04.06.2020, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr.91, datë 26.02.2020, vetëm për dy kandidatet, znj.{...} dhe znj.{...}.

Gjatë procedurës së verifikimit, kandidatja {...}, ndërsa kandidoi rishtazi edhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, më datë 04.08.2020, duke çuar mbi tre numrin e kandidimeve të saj, rikonsideroi kandidimet për ngritjen në detyrë, duke u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Mbi këtë bazë, me Vendimin nr.289, datë 08.09.2020, Këshilli vendosi: “Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale,



të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion”.

Pas kësaj, procedura e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.91, datë 26.02.2020, vijoi vetëm për kandidaten znj.{...}.

Gjatë procedurës së verifikimit, kandidatja {...}, ndërsa kandidoi rishtazi edhe për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, më datë 23.10.2020, duke çuar mbi tre numrin e kandidimeve të saj, rikonsideroi kandidimet për ngritjen në detyrë, duke hequr dorë nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Mbi këtë bazë, Këshilli me Vendimin nr. 538, datë 05.11.2020, vendosi: “Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion”.

Në situatën aktuale, rezulton se në procedurën për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.91, datë 26.02.2020, të mos ketë më asnjë kandidat. Pikërisht për këtë shkak, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Shkaku i përgatitjes së këtij projektvendimi është fakti se vazhdimi i kësaj procedure ngritjeje në detyrë është bërë i pamundur, pikërisht për mungesë të kandidatëve.

Sipas pikës 3, të nenit 90, të Kodit të Procedurave Administrative, “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Ndërsa sipas nenit 95, të Kodit të Procedurave Administrative, “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Projektvendimi i propozuar përbëhet nga 1 pikë, në të cilën përcaktohet përfundimi i procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja në fuqi e tij, pikërisht me njëherë me publikimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Vlen të përmendet se, në këtë projektvendim nuk parashikohet e drejta e ankimit kundër tij, sa kohë ai prek vetëm interesat e dy kandidatëve, znj.{...} dhe znj.{...}, të cilat janë tërhequr nga kandidimi, tërheqje për të cilat Këshilli ka disponuar më parë me vendimet respektive.

Miratimi i projektvendimit të propozuar, hap rrugën për rihapjen nga Këshilli të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim.

**Brikena Ukperaj:** Zonja Kryetare, mund të flas pak lidhur me projekt-aktin?

**Naureda Llagami:** Po!

**Brikena Ukperaj:** Unë mendoj që tërheqja e kandidatëve nga procedurat e ngritjes në detyrë, plotësimin e këtij pozicioni, nuk përbën shkak për mbylljen e procedurës, por përbën shkak për rihapjen e procedurës. Pra, në një procedurë në të cilën ne e kemi shpallur dhe vijon, kur të gjithë kandidatët e kësaj procedure tërhiqen, ajo thjesht rishpallet, sikundër edhe Komisioni i Karrierës na e ka propozuar në pikën 3 të rendit të ditës. Nuk ka sens që ne të mbyllim njëherë procedurën dhe pastaj ta rihapim prapë sepse mbyllja e procedurës ndodh vetëm në atë rast kur suprimohet pozicioni i lirë, jo kur nuk ka kandidatë. Kur nuk ka kandidatë dhe për sa kohë ai vend i lirë, ai pozicion është i tillë,

ne do rihapim procedurën derisa të ketë një kandidat, qoftë edhe një i vetëm. Prandaj, neni 90 dhe 95 i Kodit të Procedurës Administrative, vlerësoj që nuk zbatohet në këtë rastin konkret. Nuk është e nevojshme që Këshilli ta mbyllë njëherë këtë procedurë ose të përfundojë këtë procedurë dhe ta rihapë përsëri, por thjesht rishpall edhe një herë hapjen e procedurës për të bërë thirrje për ardhjen e kandidatëve të tjerë.

Pra unë mendoj që nuk është e nevojshme marrja e këtij vendimi për të mbyllur njëherë procedurën, për të përfunduar procedurën dhe për ta rihapur prapë sepse vlerësoj që situata është e njëjtë si kur nuk ka kandidatë, ashtu edhe sikundër të gjithë kandidatët që kanë kandiduar janë tërhequr. Në fund të fundit ne s'kemi kandidatë për këtë procedurë, prandaj do ta rishpallim përsëri.

Nuk e di, - u dëgjova?

**Naureda Llagami:** Po Brikena, u dëgjove.

Ndonjë diskutim tjetër?

Nga ana e Komisionit propozues.

**Ilir Toska:** E kemi bërë një propozim.

Zonja Ukperaj ka mendimin e saj.

**Naureda Llagami:** Zonja Ukperaj, kalojmë tek propozimi juaj konkret për ta hedhur në votim?

**Marçela Shehu:** Të kalojë njëherë propozimi i Komisionit dhe pastaj propozimi i zonjës Ukperaj, në qoftë se nuk miratohet propozimi i Komisionit.

**Ilir Toska:** Atëherë, ka vetëm një propozim.

Zonja Ukperaj nuk ishte dakord me projekt-propozimin që ka bërë Komisioni. Shprehu qëndrimin kundër. Nuk është se ka ndonjë propozim konkret. Kështu që i vetmi propozim është ky i Komisionit, që duhet të hidhet në votim, nëse s'ka ndonjë diskutim tjetër.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në votim propozimin e Komisionit.

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Që të sqarohemi, u hodh në votim propozimi i Komisionit?

**Naureda Llagami:** Po Bruna!

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Medi Bici:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 20.11.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i 4 projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

2.1 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

2.2 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

2.3 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

2.4 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| 5. <i>Brunilda Kadi</i>     | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Dritan Hallunaj</i>   | <i>(anëtar)</i>  |
| 7. <i>Illir Toska</i>       | <i>(anëtar)</i>  |
| 8. <i>Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| 9. <i>Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtar)</i>  |
| 10. <i>Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i> |
| 11. <i>Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i 4 projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Illir Toska):

2.1 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

2.2 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

2.3 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

2.4 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës, e cila ka të bëjë në fakt me shqyrtimin e katër projektvendimeve të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të

Karrierës, që bëjnë fjalë për rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për katër pozicione. Për më shumë detaje, fjalën ia jap sërish zotit Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur katër projektvendime “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

Lidhur me këto projektvendime është përgatitur edhe relacioni shpjegues. Shkurtimisht mund t’ju them se Këshilli i Lartë Gjyqësor pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pesë pozicione të lira, nëpërmjet Vendimeve nr. 93, nr. 94, nr. 95, nr. 96 dhe nr. 97, datë 26.02.2020, duke përcaktuar dhe afatet respektive të kandidimit për secilën procedurë ngritjeje në detyrë.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e parë të lirë të hapur me Vendimin nr. 93, datë 26.02.2020, pra deri më datë 29.04.2020, aplikoi një kandidat, ndërkohë që me Vendimin nr.153, datë 06.05.2020, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin e vetëm për këtë pozicion, duke caktuar dhe relatorin përkatës.

Në procedurat e tjera të ngritjes në detyrë, konkretisht në procedurën e dytë, të tretë dhe të katërt, të hapura me Vendimet nr. 94, nr. 95 dhe nr. 96, datë 26.02.2020, brenda afateve të kandidimit, që kanë përfunduar respektivisht më datë 06.05.2020, më datë 13.05.2020 dhe më datë 20.05.2020, nuk aplikoi asnjë kandidat.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në tre procedurat si më lart të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, meqenëse në këtë gjykatë vijonin të ekzistonin tre pozicione të lira, të cilat do të duhet të plotësoheshin përmes ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, Këshilli me Vendimet e tij nr. 162, nr. 163 dhe nr. 164, datë 28.05.2020, vendosi të rihapte procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për të tre këto pozicione të lira.

Brenda afatit të kandidimit për tre procedurat e rihapura të ngritjes në detyrë, afat ky që përfundoi më datë 22.06.2020, nuk kandidoi përsëri asnjë gjyqtar.

Përveç sa sipër, brenda afatit të kandidimit për pozicionin e pestë të lirë, atë të shpallur me Vendimin nr. 97, datë 26.02.2020, afat i cili përfundoi më datë 27.05.2020, nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Kështu, në total në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ekzistonin katër pozicione të lira, ndërkohë që vijonte e njëjta nevojë për plotësimin e tyre. Për këtë arsye, Këshilli me Vendimet nr. 220, nr. 221, nr. 222 dhe nr. 223, datë 02.07.2020, vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në këtë gjykatë, në total për katër pozicione të lira.

Ndërkohë, më datë 05.03.2020, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, u shkarkua nga detyra një gjyqtar tjetër i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke u krijuar kështu edhe një pozicion tjetër të lirë, i cili do të duhej të plotësohej nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Për rrjedhojë, Këshilli me Vendimin nr. 224, datë 02.07.2020, vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në këtë gjykatë për një pozicion të lirë.

Brenda afatit të kandidimit për të pesta procedurat e ngritjes në detyrë, të hapura ose rihapura sipas vendimeve si më lart të Këshillit, afat ky që përfundoi 26.07.2020, rezultoi që vetëm për një nga pozicionet e lira, të kandidonte një gjyqtar. Ndërsa në procedurat e tjera për katër pozicione të lira, nuk aplikoi përsëri asnjë gjyqtar.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në katër procedurat si më lart të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërsa në këtë gjykatë vijonin të ekzistonin katër pozicionet e lira si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, Këshilli me Vendimet nr.301, nr.302, nr.303 dhe nr.304, datë 10.09.2020, vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në këtë gjykatë, në total për katër pozicione të lira.

Brenda afatit të kandidimit për këto procedura ngritjeje në detyrë, afat ky që përfundoi më datë 24.09.2020, nuk kandidoi përsëri asnjë gjyqtar.

Për rrjedhojë, për të njëjtat shkaqe si më parë, ndërsa në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vijonin të ekzistonin katër pozicione të lira, si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, Këshilli me Vendimet nr.



436, nr. 437, nr. 438 dhe nr. 439, datë 14.10.2020, vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në këtë gjykatë, në total për katër pozicione të lira.

Brenda afatit të kandidimit për këto procedura ngritjeje në detyrë, afat ky që përfundoi më datë 30.10.2020, nuk kandidoi përsëri asnjë gjyqtar.

Ndaj sa më sipër, mbështetur në të njëjtën bazë ligjore, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar katër projektvendime për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për katër pozicione të lira. Të katër projektvendimet titullohen “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

Sipas projektvendimeve të propozuara, afati i kandidimit është vlerësuar të jetë i njëjtë. Në projektvendime dhe në relacion, Komisioni ka dërguar për shqyrtim në Këshill më datë 05.11., kështu që referuar kohës kur janë përgatitur projektvendimet të cilat ju i keni për shqyrtim ditën e sotme, afati është përcaktuar deri më 01.12.2020. Në fakt, ne e rikonsiderojmë këtë afat, pasi është më i shkurtër se afati minimal që përcakton ligji. Mund të konsiderojmë që të përcaktojmë si afat për të gjitha kandidimet si afat kandidimi datën 10.12.2020.

Sa i përket përmbajtjes së projektvendimeve, ato janë strukturuar në 4 Krerë, me të njëjtën përmbajtje, si dhe në rastin e hapjes ose rihapjes së procedurave për ngritjen në detyrë për këto pozicione të lira.

Bashkëlidhur projektvendimeve janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Toska!

Fillojmë me projekt-aktin e parë i cili ka të bëjë me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë me afatin e kandidimit i cili është deri më datë 01.12.2020. Kalojmë në votim?

***Ilir Toska:*** Të lutem! Rikonsideruam afatin dhe thamë datën 10 dhjetor.

***Brikena Ukperaj:*** Mund të shtoj diçka Ilir?

Mund ta rikonsiderojmë një afat më gjatë, ndoshta një muaj për kandidimet sepse ne e kemi parë, situata në të gjithë vendin është problematike. Gjykatat janë të gjithë të pezulluara. Po kështu, shumica e gjyqtarëve, sipas informacioneve që kemi, janë të diagnostikuar me COVID. Ne kemi parë që brenda afatit 2-javor pothuajse nuk kemi asnjë kandidatim. Ndoshta mos do ishte më mirë që ta bëjmë afatin 1 muaj, që të mos rrimë hap e mbyll procedura?

**Ilir Toska:** Në fakt, afati që u propozua ditën e sotme i kap 20 ditë.

**Brikena Ukperaj:** 20 ditë.

Okej! Në rregull! Dakord!

**Naureda Llagami:** Atëherë, sa do ta lëmë afatin?

**Ilir Toska:** Data 10.12.2020.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë projekt-aktin e parë “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, me afat kandidimi deri më datë 10.12.2020. Jemi dakord?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë tek projekt-akti i dytë, që është “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, me afat kandidimi deri më datë 10.12.2020. Votim!

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Rihapjen e procedurës për ngritjen në detyrë për një pozicion të lirë, sipas propozimit të Komisionit.

Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë prapë me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë për një pozicion të lirë, me afat kandidimi deri më datë 10.12.2020. Kalojmë në votim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë tek projekt-akti i radhës “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, me afat kandidimi deri më datë 10.12.2020.

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Illir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 20.11.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i 3 projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

3.1 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

3.2 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

3.3 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| <i>7. Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>8. Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtar)</i>  |
| <i>10. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i> |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i 3 projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

3.1 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

3.2 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

3.3 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjet e tjera që kanë të bëjnë me shqyrtimin e tre projektvendimeve, edhe këto të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, për sa i përket rihapjes së procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për tre pozicione të lira. Për më shumë detaje, fjalën prapë e ka zoti Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur tre projektvendime “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, -në secilin rast- për një pozicion të lirë”.

Edhe në këtë rast kemi përcjellë edhe relacionin shpjegues lidhur me këto projektvendime. Shkurtimisht mund t’ju them se Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur fillimisht prpcedurat për pesë pozicione të lira për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nëpërmjet Vendimeve nr. 88, nr. 89, nr. 90, nr. 91 dhe nr. 92, datë 26.02.2020, duke përcaktuar dhe afatet respektive të kandidimit për secilën procedurë ngritjeje në detyrë.

Në përfundim të afateve të kandidimit, për katër procedurat e para të ngritjes në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, rezultoi të aplikonin katër gjyqtarë. Ndërsa, në procedurën e pestë, për pozicionin e lirë të hapur me Vendimin nr. 92, datë 26.02.2020, brenda afatit të kandidimit, që përfundoi më datë 27.05.2020, nuk aplikoi asnjë gjyqtar.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në procedurën e pestë si më lart të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe duke qenë se vijonte të ekzistonte ky pozicion si i lirë dhe nevoja për plotësimin e tij, me Vendimin nr. 225, datë 02.07.2020, Këshilli vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në këtë gjykatë për një pozicion të lirë.

Përveç sa sipër, më datë 17.06.2020, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, u shkarkua nga detyra një gjyqtar tjetër i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke u krijuar kështu edhe një pozicion tjetër të lirë, i cili do të duhej të plotësohej nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Për këtë, me Vendimin nr. 226, datë 02.07.2020, Këshilli vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në këtë gjykatë për një pozicion të lirë.

Brenda afatit të kandidimit në këto dy procedura ngritjeje në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat ky që përfundoi më datë 26.07.2020, nuk kandidoi përsëri asnjë gjyqtar.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në dy procedurat si më lart të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar, ndërsa në këtë gjykatë vijonin të ekzistonin dy pozicione të lira, si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, me Vendimet nr.305 dhe nr.306, datë 10.09.2020, Këshilli vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në këtë gjykatë, në total për dy pozicione të lira.

Brenda afatit të kandidimit në këto dy procedura ngritjeje në detyrë pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat ky që përfundoi më datë 24.09.2020, nuk kandidoi përsëri asnjë gjyqtar.

Pas kësaj, për të njëjtat shkaqe si më lart, ndërsa në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vijonin të ekzistonin dy pozicione të lira, si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, me Vendimet nr. 440 dhe nr. 441, datë 14.10.2020, Këshilli vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në këtë gjykatë, në total për dy pozicione të lira.

Edhe në këtë rast, brenda afatit të kandidimit në këto dy procedura ngritjeje në detyrë, afat ky që përfundoi më datë 30.10.2020, nuk kandidoi përsëri asnjë gjyqtar.

Ndërkohë, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar aktualisht ekziston edhe një pozicion i tretë i lirë, i cili duhet të plotësohet nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Ky pozicion i lirë është pikërisht pozicioni për të cilin pak më herët, ne vendosëm përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.91, datë 26.02.2020.

Ndërsa u miratua ky projektvendim i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, do duhet të konsiderojmë që aktualisht në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ekzistojnë tre pozicione të lira të cilat duhet të plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

Ndaj sa më sipër, në kushtet e ekzistencës së tre pozicioneve të lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, mbështetur në të njëjtën bazë ligjore, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar tre projektvendime për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për tre pozicione të lira. Të tre projektvendimet titullohen “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”.



Sipas projektvendimeve të propozuara, ndërsa janë nisur që në datën 5 nëntor afati është përcaktuar “deri më datë 01.12.2020”. Në fakt do duhet ta konsiderojmë tashmë siç konsideruam edhe më herët për rihapjen e procedurave në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe të përcaktojmë këtë afat deri në datë 10 dhjetor 2020.

Sa i përket përmbytjes së projektvendimeve, ato janë strukturuar në 4 Krerë, me të njëjtën përmbytje, si dhe në rastin e hapjes ose rihapjes së procedurave për ngritjen në detyrë për këto pozicione të lira.

Bashkëlidhur projektvendimeve janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit të parë i cili ka të bëjë me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë, me afat kandidimi deri më datë 10.12.2020. Jemi dakord?

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Illir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë tek projekt-akti i radhës, “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, me afat kandidimi deri më datë 10.12.2020.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Rihapjen e procedurës për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për një pozicion të lirë, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë tek projekt-akti i radhës “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për një pozicion të lirë, me afat kandidimi deri më datë 10.12.2020. Jemi dakord?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë, sipas propozimit të bërë nga Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 20.11.2020)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendim nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)  
10. *Marçela Shehu* (anëtare)  
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendim nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përparuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale...”. Për më shumë detaje fjalën ia jap relatorit të çështjes, z. Alban Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Shkurtimisht, sepse relacionin ka kohë që e keni në dispozicion. Më lejoni të theksoj që me vendimin nr. 396, 07.10.2020, KLGJ ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarëve pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë

në fushën e të drejtës penale. Gjithashtu, më herët, me vendimet nr. 174, nr. 184 dhe nr. 185 kanë filluar procedurat për ngritjen në detyrë në gjykatat e apeleve të juridiksionit të përgjithshëm. Një nga kandidaturat për këto pozicione ka qenë edhe gjyqtarja {...} e cila ka kandiduar dhe për të cilën janë kryer procedurat e verifikuese të mëparshme, ku me vendimin nr. 284, datë 08.09.2020 ky Këshill ka vendosur: “Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 174, dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit, nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2.Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore... .”

Më lejoni të theksoj që në bazë të vendimit nr. 75/2019, pika 7, Seksioni B, Kreun VI “procedura standarde verifikuese e realizuar në rastin më të parë është e vlefshme për çdo procedurë tjetër kandidimi të atëkohshme”. Rrjedhimisht, përfundimit të realizuar me vendimin e mëparshëm për pozicionet e lira të hapura, do të jenë të vlefshme edhe për këtë pozicion.

Ndërkohë, nga ana e kandidatës është rikonsideruar kërkesa e saj dhe ka depozituar tërheqje nga kandidimi për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 174, 28.05.2020 për Gjykatën e Apelit Durrës.

Si rrjedhojë e kësaj kërkesë ky Këshill është përgjigjur me vendimin nr. 539, 05.11.2020 ku ka përfunduar procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, shpallur me vendimin nr. 174, datë 28.05.2020 për kandidaten Migela {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

Pra në këto kushte, duke pasur parasysh dhe marrë në konsideratë përfundimet e mëparshme, ka rezultuar që zonja Migela {...} gëzon kriterin e përvojës profesionale minimale, gjithashtu nuk ka të dhëna për masë disiplinore në fuqi si dhe nga dokumentacioni i administruar, gjatë verifikimit, vlerësohet se {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatë papajtueshmërie ambientale në rastin e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Në këto kushte Komisioni ka përgatitur projekt-draftin e vendimit, në bazë të të cilit ju propozohet: 1. Verifikimi i plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 396, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 396, datë 07.10.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Toro!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës?

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ilir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendim nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 20.11.2020)*

***Pika 5 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 392, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                                  |                                 |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <b><i>1. Naureda Llagami</i></b> | <b><i>(kryetare)</i></b>        |
| <b><i>2. Maksim Qoku</i></b>     | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b><i>3. Medi Bici</i></b>       | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b><i>4. Fatmira Luli</i></b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>5. Brunilda Kadi</i></b>   | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b><i>6. Dritan Hallunaj</i></b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |

- |                             |                  |
|-----------------------------|------------------|
| 7. <i>Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| 8. <i>Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>  |
| 9. <i>Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtar)</i>  |
| 10. <i>Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i> |
| 11. <i>Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>  |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 392, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës. Edhe ky ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 392, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje, fjalën ia jap relatores znj. Marçela Shehu.

**Marçela Shehu:** Faleminderit, Kryetare!

Projektvendimi dhe relacioni i përgatitur lidhet pikërisht me verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 187, dhe në Gjykatën e Apelit Durrës për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile, pozicion ky i shpallur me vendimin nr. 392, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pas procedurës së verifikimit, që në mënyrë të detajuar është parashtruar në relacionin që ju tashmë e dispononi, ka rezultuar se z. {...} përmbush kriteret që përcakton ligji dhe konkretisht kriteret e përvojës profesionale minimale, të mospasjes së masës disiplinore në fuqi dhe të mosqenies në situatën e papajtueshmërinë ambientale. Pra plotëson kriteret formale për të vijuar më tej procedurën e verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Z. {...} përmbush këto kriteret formale për të dyja pozicionet, pra edhe për pozicionin në Gjykatën Administrative, edhe për pozicionin në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin në fushën civile.

Në këto kushte, i propozohet Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikimi i plotësimit nga kandidati të këtyre kriterëve formale dhe vijimi i procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit, sipas propozimit të Komisionit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 392, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 20.11.2020)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e këshillit nr. 187, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)  
10. *Marçela Shehu* (anëtare)  
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e këshillit nr. 187, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje, ia jap sërish fjalën relatores znj. Marçela Shehu.

*Marçela Shehu:* Po, Kryetare!

Gjyqtarja zonja {...} ka kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 187, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Lidhur me këtë kandidim është realizuar procedura e verifikimit paraprak lidhur me plotësimin nga kjo kandidate të kritereve

formale dhe në përfundim të këtij procesi të verifikimit deri tani ka rezultuar se kjo kandidate përmbush kriteret e përvojës profesionale minimale, të mospasjes masë disiplinore në fuqi dhe të mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale. Në këto kushte, i propozohet Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikimi i plotësimit nga kjo kandidate të këtyre kriterëve formale dhe vijimi i procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 187. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 20.11.2020)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtarës {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)



Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e gjyqtarës {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me përjashtimin e gjyqtarës {...} nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Relator i kësaj çështjeje është zoti Alban Toro.

*Alban Toro:* Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar një kërkesë e gjyqtarës {...} me nr. 373, 06.11.2020 në bazë të së cilës konkludohet se kërkon përjashtimin nga gjykimi i çështjeve të veçanta në gjykata të tjera.

Në motivimin që ajo ka bërë në kërkesën e saj, ndër të tjera thuhet: “...për shkak të diagnostikimit të vajzës së saj (Amina) me Torticollis që në javën e tretë pas lindjes, nga ana e mjekut specialist i është këshilluar ndjekja e një programi të vazhdueshëm fizioterapie. Mjeku kirurg pediatër, gjatë konsultave periodike me të është shprehur se vetëm me dështimin e fizioterapisë vajza duhet t’i nënshtrohet detyrimisht operacionit kirurgjikal. Në bazë të rekomandimeve mjekësore përmirësimi dhe shërimi i plotë i

vajzës varet nga përkushtimi i përditshëm në kushtet e shtëpisë. Kjo nënkupton që delegimi im për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër të ndryshme ku ushtrij funksionin në mënyrë të përhershme komplikon rrethanat familjare në të cilat ndodhem aktualisht...”. Bashkëlidhur kësaj kërkesë ajo ka bashkëlidhur të gjitha analizat mjekësore të cilat konfirmojnë diagnozën e tillë.

Në këto kushte, Komisioni ka konkluduar në bazë të Rregullores së miratuar me vendimin nr. 30, datë 14.02.2019, të miratojë një kërkesë të tillë, duke përgatitur projekt-aktin përkatës në bazë të së cilit ju propozohet: 1. Përrjashtimin e gjyqtares znj. {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, për një afat 6 (gjashtë) mujor.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kalojmë në votimin nëse nuk kemi ndonjë diskutim nga kolegët?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Përrjashtimin e gjyqtares znj. {...}, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, për një afat 6 (gjashtë) mujor. 2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 20.11.2020)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)  
10. *Marçela Shehu* (anëtare)  
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e vendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”. Për më shumë detaje fjalën ia jap z. Ilir Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Nga ana e Komisionit dhe në cilësinë si relator i procedurës së verifikimit për zotën {...} është përcjellë një relacion për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin të tre prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e

Lartë nga radhët e gjyqtareve, të kandidatit z. {...}, i cili ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 245, datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ndërkohë zoti {...}, më herët ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë për pozicionet e lira në fushën e së drejtës administrative, pikërisht ato të shpallura me vendimet nr. 82 dhe nr. 83, datë 26.02.2020. Në kuadër të verifikimit të tre prej kriterëve ligjore të kandidimit, pra të kriterit të përvojës profesionale minimale, të mospasjes masë disiplinore në fuqi dhe të mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale për dy nga kandidimet e para, pra për ato të shpallura me vendimet nr. 82 dhe nr. 83, të datës 26.02.2020, Këshilli me vendimin nr. 216, datë 18.06.2020 ka vendosur që kandidati zoti {...} plotëson të tre kriteret formale të kandidimit të tij për në Gjykatën e Lartë, për pozicionet në fushën e të drejtës administrative.

Referuar kësaj, në vendimin kur është filluar procedura e verifikimit sa i përket kandidimit të zotit {...} për pozicionin nr. 245, Këshilli ka konsideruar që verifikimet e kryera në rastet e mëhershme janë të vlefshme edhe për kandidimin e zotit {...} për pozicionin më të fundit ku ai ka aplikuar.

Nisur nga kjo, ndërsa konsiderohen të gjithë materialet e grumbulluara për verifikimin paraprak të dy kandidimeve të para, gjithashtu edhe në rastin e kandidimit më të fundit të zotit {...}, është konkluduar se ai i plotëson të tre kriteret formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë edhe për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 245, datë 09.07.2020.

Në fakt, ky material ju është përcjellë për shqyrtim që në datën 28 gusht 2020, por rezultoi që më pas zoti {...} të jetë zgjedhur anëtar i Kolegjit Zgjedhor në datën 9 shtator 2020, ku referuar përcaktimit të bërë në Kodin Zgjedhor, neni 149, kjo procedurë verifikimi u stopua, ndërsa ka pasur një nismë ligjore për ndryshimin e kësaj dispozite ligjore. Aktualisht, dispozita ligjore që pengonte promovimin në detyrë të gjyqtarëve që zgjidheshin si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor ka rënë, kjo me ligjin nr.18/2020, ku është shfuqizuar togfjalëshi “apo ngritje në detyrë”, në shkronjën /b/, pika 1, e nenit 149 të Kodit Zgjedhor. Ky ligj është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 191, datë 03.11.2020 dhe aktualisht është në fuqi.

Në këto kushte, në cilësinë e relatorit, i propozoj Këshillit që të vendosë verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.245, datë 09.07.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 245, datë 09.07.2020. Duke nënkuptuar në këtë rast, vijimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës për të. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të sjellë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 20.11.2020)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)  
10. *Marçela Shehu* (anëtare)  
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”. Për më shumë detaje fjalën ia jap sërish zotit Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Zoti {...} ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020. në këtë rast, referuar edhe vendimit të sipërpërmendur për kandidatin është bërë verifikimi dhe për këtë procedurë verifikimi jam caktuar unë në cilësinë e relatorit me vendimin nr. 238,

datë 07.07.2020. Ndërkohë është bërë verifikimi paraprak për tre kriteret formale të kandidimit për ngritjen në detyrë. Në relacion janë shpjeguar e gjithë procedura e ndjekur për grumbullimin e dokumentacionit. Ka rezultuar që kandidati të plotësojë të tre kriteret formale të kandidimit të tij për në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin nr. 187, datë 28.05.2020.

Në këtë rast, materiali i verifikimit, pra relacioni përkatës është dërguar për shqyrtim në Këshill në datën 25 gusht 2020, ndërkohë zoti {...} është përzgjedhur edhe ky anëtar i Kolegjit Zgjedhor më datën 9 shtator 2020. Për këtë shkak u ndërpre shqyrtimi i rezultateve të verifikimit paraprak për zotin {...}. Po ashtu, një shkak tjetër që u ndërpre shqyrtimi i rezultateve të verifikimit paraprak për zotin {...}, ishte edhe fakti se Këshilli në datën e mbledhjes 10 shtator konsideroi që do të vijonin procedurat e shqyrtimit të rezultateve të verifikimit për kandidatët për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, pasi më parë të dispononte në lidhje me vijimin për një nga pozicionet e lira të shpallura për Gjykatën Administrative të Apelit. Kjo gjë ka ndodhur dhe Këshilli ka marrë vendimin nr. 398, datë 07.10.2020, me të cilën ka disponuar “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë pranë Gjykatës Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 188, datë 28.05.2020”. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

Në këto kushte, në cilësinë e relatorit i propozoj Këshillit që të vendosë: 1. Verifikimin e plotësimin nga kandidati z.{...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 187, datë 28.05.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. 2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 187, datë 28.05.2020. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votim?

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Illir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 187, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 20.11.2020)*

**Pika 10 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b> | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë edhe kjo me verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative dhe një në fushën e të drejtës civile. Për më shumë, fjalën ia jap zotit Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Atëherë, në shqyrtim kemi rezultatet e verifikimit paraprak për tre kriteret formale të kandidimit të zotit {...}, i cili ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.87, datë 26.02.2020. Për të tre këto pozicione, zoti {...} ka kandiduar brenda afatit të kandidimit. Afati i kandidimit në të tre rastet ka përfunduar në datën 30 korrik 2020.

Për zotin {...} janë grumbulluar dokumentacion nga Departamenti i Shërbimeve po kështu edhe nga gjykatat ku zoti {...} ka ushtruar funksionin e gjyqtarit. Nga të dhënat e grumbulluara, ka rezultuar se zoti {...} plotëson kriterin e përvojës profesionale minimale, qoftë atë të përgjithshme prej 13 vjetësh, ashtu edhe atë të veçantë prej 5 vjetësh, në fushën e të drejtës civile dhe administrative. Po kështu ka rezultuar se zoti {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi, sikundër po ashtu ka rezultuar se zoti {...} nuk gjendet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast se zgjidhet në funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Mbi këtë bazë rezultatet e verifikimit i janë përcjellë Këshillit që në datën 15 shtator 2020, por ndërsa ka rezultuar që zoti {...} të zgjidhet si anëtar i Kolegjit Zgjedhor në datën 9 shtator 2020, procedura e shqyrtimit të rezultateve të verifikimit paraprak është stopuar, derisa tashmë ditën e sotme, pengesa që përcaktonte Kodi Zgjedhor për ngritjen në detyrë të anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor ka rënë dhe ne mund të vijojmë normalisht procedurën e nisur.

Mbi këtë bazë, në cilësinë e relatorit, i propozoj Këshillit që të vendosë:

- 1.Verifikimin e plotësimit nga kandidati z.{...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të

shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Illir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 20.11.2020)*

**Pika 11 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për:

11.1 Emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

11.2 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

11.3 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

11.4 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

11.5 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

11.6 Emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës;

11.7 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës;

11.8 Emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Korçë;

11.9 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:55.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i>   | <i>(kryetare)</i>        |
| <i>2. Maksim Qoku</i>       | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i>         | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>4. Fatmira Luli</i>      | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>5. Brunilda Kadi</i>     | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i>   | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Ilir Toska</i>        | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>8. Alban Toro</i>        | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i>   | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>10. Marçela Shehu</i>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>11. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

11. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, për:

11.1 Emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;

- 11.2 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
- 11.3 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
- 11.4 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
- 11.5 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
- 11.6 Emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës;
- 11.7 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës;
- 11.8 Emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Korçë;
- 11.9 Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktet e radhës që kanë të bëjnë me shqyrtimin e disa projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, të cilat kanë të bëjnë me pjesën e emërimit të përkohshëm të ndihmësve ligjorë të shkallës së parë administrative në gjykatat e apelit, sipas juridiksionit ku ato ushtrojnë funksionin. Për më shumë detaje fjalën po ia jap znj. Luli për relativimin e projekt-aktit.

*Fatmira Luli:* Faleminderit, Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësive për drejtimin dhe kujdesjen për administrimin e të gjithë gjykatave, ka miratuar me Vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor Rregulloren mbi procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatëve për Kancelarë, për Këshilltarë ose për Ndihmës Ligjorë. Një vendimmarrje e tillë u bazua në nenin 147/a, pika 1, shkronja “d”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr.98/2016 “Për

organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (nenet 53, 55 dhe 83), në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (neni 165), si dhe në nenin 6 të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave më të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit, si dhe të pasurisë dhe të figurës (për disa kategori kandidatësh), të kandidatit për kancelar, për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, përfshirë këtu dhe kandidatit për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë.

Ndërkohë që subjektet e këtij vendimi (vendimit nr. 424 të Këshillit të Lartë Gjyqësor) janë listuar në pikën 2, shkronja “a” të Kreut I, dhe konkretisht janë:

i) kandidati për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit;

ii) kandidati fitues në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit;

iii) kandidati për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit;

iv) kancelari në detyrë, këshilltari ligjor në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe ndihmësi ligjor në detyrë në gjykatat administrative.

Gjithashtu në Kreun XI të Vendimit nr. 424, datë 12.10.2020 të KLGJ-së, titulluar “Dispozita për kancelarët, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, në detyrë” ndarë në tre seksione, konkretisht A, B dhe C rregullohet mënyra se si do të bëhet verifikimi, emërimi në shërbimin civil gjyqësor ose ndërprerja e marrëdhënieve të punës: për kancelarët në detyrë; për këshilltarët ligjorë në detyrë në Gjykatën e Lartë; për ndihmësit ligjorë në detyrë në gjykatat administrative.

Lidhur me ndihmësit ligjorë në detyrë në gjykatat administrative të shkallës së parë, neni 165 i ligjit për Statusin ka parashikuar që ata do të qëndrojnë në detyrë deri në përfundimin të marrëdhënies së punës për arsye ligjore ose si rezultat i procesit të rivlerësimit duke u emëruar përkohësisht në gjykatat e apelit, si rregull, në gjykatat e

apelit që mbulojnë të njëjtin juridiksion tokësor. Emërimi bëhet nga Këshilli, jo më vonë se 7 ditë nga krijimi i njësive të shërbimit ligjor në gjykatat e apelit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendim nr. 495, datë 21.10.2020 “Për krijimin e njësive të shërbimit ligjorë pranë gjykatave të apelit”, ka krijuar njësitë e shërbimit ligjor, si pjesë e organikës së gjykatave të apelit.

Duke marrë shkas nga sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet që ndihmësit ligjorë në detyrë në gjykatat administrative të shkallës së parë, t’i emërojë përkohësisht, pranë Njësive të Shërbimit Ligjor në gjykatën e apelit që mbulon të njëjtin juridiksion tokësor.

Lidhur me ndihmësit ligjorë në detyrë në gjykatat administrative, sjellim në vëmendje se, bazuar në nenin 179/b, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë subjekte ex officio të rivlerësimit kalimtar. Si të tillë, përveçse kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, ajo mund të mbarojë dhe si rezultat i procesit të rivlerësimit.

Kjo e drejtë parashikohet edhe në nenin 9 të Ligjit nr. 39/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar”.

Në bazë të Vendimit nr. 495, datë 21.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Njësitë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatave të Apelit kanë në organikë: Gjykata e Apelit Tiranë, 15 ndihmës ligjorë; Gjykata e Apelit Shkodër, 5 ndihmës ligjorë; Gjykata e Apelit Durrës, 6 ndihmës ligjorë; Gjykata e Apelit Korçë, 3 ndihmës ligjorë.

Nga dokumentacioni, që disponohet nga drejtoria që mbulon burimet njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, konstatohet se në organikën e gjykatave të apelit, lidhur me pozicionin “ndihmës ligjor”, janë të emëruar 3 të tillë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Ndërkohë që, pranë gjykatave administrative të shkallës së parë, ka gjithsej 9 ndihmës ligjorë të emëruar për zbatim të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Konkretisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, janë 5 ndihmës ligjorë: 1. Z. {...}; 2. Znj. {...}; 3. Znj. {...}; 4. Znj. {...}; 5. Znj. {...}.

Si dhe 4 ndihmës ligjor në gjykatat administrative të shkallës së parë në rrethe, respektivisht: 1. Z. {...}, Gj. Administrative e Shkallës së Parë Durrës; 2. Znj. {...}, Gj. Administrative e Shkallës së Parë Durrës; 3. Znj. {...}, Gj. Administrative e Shkallës së Parë Shkodër; 4. Z. {...}, Gj. Administrative e Shkallës së Parë Korçë.

Në rastin e supozuar të emërimit të përkohshëm të tyre, në gjykatat e apelit që mbulojnë të njëjtin juridiksion tokësor me gjykatat ku ushtrojnë detyrën, nuk do të tejkalohet numri i përcaktuar në organikën e gjykatës përkatëse. Nisur nga numri stoku i dosjeve gjyqësore, numri i përcaktuar nga vendimi aktual pranë gjykatave të apelit, si dhe strukturën administrative dhe atë buxhetore të gjykatave të apelit, vlerësojmë se është i mundur emërimi i përkohshëm i 9 kandidatëve për ndihmës ligjorë pranë gjykatave respektive si më poshtë: 1. Për emërimin e përkohshëm, në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Tiranë, të ndihmësit ligjor, z. {...}” i cili ishte në Tiranë në shkallën e parë. 2. Për emërimin e përkohshëm, në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Tiranë, të ndihmësit ligjor, znj. {...}” e cila ishte edhe kjo në shkallën e parë Tiranë administrative. 3. Për emërimin e përkohshëm, në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Tiranë, të ndihmësit ligjor, znj. {...}”. 4. Për emërimin e përkohshëm, në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Tiranë, të ndihmësit ligjor, znj. {...}”. 5. Për emërimin e përkohshëm, në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Tiranë, të ndihmësit ligjor, znj. {...}” (të tërë këto nga shkalla e parë administrative Tiranë). 6. Për emërimin e përkohshëm, në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Durrës, të ndihmësit ligjor, z. {...}”. 7. Për emërimin e përkohshëm, në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Durrës, të ndihmësit ligjor, znj. {...}” (të cilët ishin në gjykatën e shkallës së parë administrative Durrës). 8. Për emërimin e përkohshëm, në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Shkodër, të ndihmësit ligjor, znj. {...}”. 9. Për emërimin e përkohshëm, në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Korçë, të ndihmësit ligjor, z. {...}”.

Për këto janë përgatitur edhe aktet individuale të emërimit të të tërë ndihmësve ligjorë në gjykatat përkatëse të apelit.

Në pikën 1 të këtyre projektvendimeve, përcaktohet ndërprerja e marrëdhënieve të punës për ndihmësin përkatës në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Në pikën 2 të secilit prej projektvendimeve është theksuar emërimi në mënyrë të përkohshme i subjektit në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit.

Në pikën 3 është përcaktuar që efektet e juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 01.12.2020, ndërkohë që në pikën 4 parashikohet që një kopje e vendimit i njoftohet kandidatëve sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ashtu dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë si dhe Gjykatës së Apelit.

Gjithashtu në pikën 5 të vendimit përcaktohet e drejta e ankimit të kandidatit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në fund parashikohet se hyrja në fuqi e tij që është në mënyrë të menjëhershme dhe që botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, Fatmira!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim nga kolegët?

Nëse jo, fillojmë me projekt-aktin e parë i cili ka të bëjë me emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ilir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Ndërprerjen e marrëdhënies së punës të ndihmësit ligjor, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, z. {...}.

2. Emërimin e përkohshëm të z. {...}, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

3. Efektet juridike dhe financiare të vendimit fillojnë në datën 01.12.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohen në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e dytë i cili ka të bëjë me emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Jemi dakord me projekt-aktin e propozuar?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Ndërprerjen e marrëdhënies së punës të ndihmëses ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, znj. {...}.



2. Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

3. Efektet juridike dhe financiare të vendimit fillojnë në datën 01.12.2020.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohen në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Jemi dakord me projekt-aktin e propozuar?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, sipas propozimi të bërë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Jemi dakord me projekt-aktin e propozuar?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, sipas propozimi të bërë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Jemi dakord me propozimin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Jemi dakord me propozimin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Emërimin e përkohshëm të z. {...}, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmëses ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Jemi dakord me propozimin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Durrës, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me emërimin e përkohshëm të z. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Korçë. Jemi dakord me propozimin e Komisionit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Emërimin e përkohshëm të z. {...}, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Shkodër. Jemi dakord me propozimin e bërë nga Komisioni?

**Maksim Qoku:** Dakord.

*Brunilda Kadi*: Dakord.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Illir Toska*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

\* \* \*

(Pika 11 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 20.11.2020)*

**Pika 12 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor në gjykatat e apelit”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:55.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoreshë pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Kelment Greca, Drejtor pranë Drejtorisë së Organizimit të Gjykatave dhe Standardeve.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

12. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor në gjykatat e apelit”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin tjetër, në fakt që është vijim i të gjithë hallkave dhe procedurave që kemi bërë deri tani, që ka të bëjë me shpalljen e vendeve vakante në pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor në gjykatat e apelit. Për më shumë detaje, shkurtimisht do doja që t’ia jepja fjalën Drejtorit të Administrimit të Gjykatave, zotit Kelment Greca.

*Kelment Greca:* Mbështetur në nenin 90, pika 1/b, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, Këshilli është organi kompetent për publikimin dhe shpalljen e konkurrimit të hapur për vendet e lira, në shërbimin civil gjyqësor.

Neni 59, i Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” parashikon se: “Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor, është Këshilli i Lartë Gjyqësor”.

Këshilli ka miratuar me vendimin nr. 495, datë 21.10.2020 “Për krijimin e njësieve të shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit” shpërndarjen e numrit të tyre me 50% të numrit të gjyqtarëve.

Në bazë të informacionit tonë që kemi për ndihmësit ligjorë në gjykatat aktuale, aktualisht janë 11 ndihmës ligjorë që janë në detyrë, duke përfshirë edhe këto 9 që shkuan tani, shkon në 20 numri i përgjithshëm.

Në Gjykatën e Apelit Tiranë, kam bërë një shpjegim, janë tre ndihmës ligjorë, por statusi i tyre (se është i paqartë statusi i tyre ligjor) është duke u diskutuar nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Këshilli me vendimin nr. 424, për procedurat e verifikimit, ka miratuar sot 9 ndihmës ligjorë që janë transferuar nga gjykatat e shkallëve të para me emërim të përkohshëm në gjykatat e apelit që mbulojnë në të njëjtin juridiksion tokësor.

Me vendimin nr. 495, gjithsej janë 52 vende të miratuara, por në vitin 2020 janë miratuar dhe buxhetuar vetëm 42 ndihmës ligjorë. Plotësimin e këtyre vendeve të përkohshme i ndihmësve nga Gjykata Administrative të Shkallëve të Para, ngelen pa plotësuar 17 vende vakante.

Përkatësisht vendet vakante pas emërimit të ndihmësve ligjorë të gjykatave administrative, do të jenë si më poshtë:

1. Gjykata e Apelit Tiranë - 6 ndihmës ligjorë;
2. Gjykata e Apelit Durrës - 1 ndihmës ligjor;
3. Gjykata e Apelit Gjirokastrë - 2 ndihmës ligjorë;
4. Gjykata e Apelit Korçë - 1 ndihmës ligjor;
5. Gjykata e Apelit Shkodër - 1 ndihmës ligjor;
6. Gjykata e Apelit Vlorë - 3 ndihmës ligjorë;
7. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar - 3 ndihmës ligjorë.

Për më shumë unë kam bërë edhe një tabelë që të jeni më të qartë si janë shpërndarë këto vakanca. Vlen të mbahet në konsideratë edhe që nga Shkolla e Magjistraturës është përcjellë edhe lista e kandidatëve që kanë përfunduar ciklin e studimeve për vitin 2019-2020.



Në zbatim të nenit 64, pika 7 e ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, kandidatët kanë depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesat për emërim dhe trajtim financiar.

Për zbatim të këtij parashikimi nënligjor vlerësohet se Këshilli, në momentin e krijimit të vakancave, duhet të mbajë në konsideratë listën emërore të 8 ndihmësve ligjorë në pritje për t’u emëruar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 424, datë 12.10.2020 “ Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose ndihmës ligjor”, ka përcaktuar mënyrën e trajtimit për kandidatët për ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit, që përfundojnë Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Konkretisht është Kreu XIV, Seksioni B, pika 149: “Kandidatët për ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit, mbi propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, emërohen përkohësisht deri në përfundim të verifikimit të pasurisë dhe figurës”.

Në këto kushte propozohet shpallja e 17 vendeve vakante të pozicionin e ndihmësve ligjorë pranë gjykatave të apelit.

Propozohet që, për ndjekjen e procedurave të rekrutimit, në të cilat përfshihet përpunimi dhe publikimi në faqen e internetit të njoftimit të vendit vakant si dhe përcaktimi i afateve për kandidim, të ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.

Lidhur me strukturën e projektvendimit, ai përbëhet nga 2 pika.

Në pikën e parë, përcaktohet shpallja e numrit total të vendeve vakante si dhe detajimi sipas gjykatave të apelit përkatëse.

Në pikën 2 të projektvendimit, përcaktohet ngarkimi i Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, për zhvillimin e procedurave të rekrutimit.

Në fund parashikohet se hyrja në fuqi e tij që është në mënyrë të menjëhershme dhe që botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Vendet që hapen, konkretisht janë të tilla:

1. Gjykata e Apelit Tiranë - 6 ndihmës ligjorë;
2. Gjykata e Apelit Durrës - 1 ndihmës ligjor;
3. Gjykata e Apelit Gjirokastrë - 2 ndihmës ligjorë;

4. Gjykata e Apelit Korçë - 1 ndihmës ligjor;
5. Gjykata e Apelit Shkodër - 1 ndihmës ligjor;
6. Gjykata e Apelit Vlorë - 3 ndihmës ligjorë;
7. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar - 3 ndihmës ligjorë. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Keni ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e projekt-aktit?

**Brikena Ukperaj:** Mund të bëj një ndërhyrje tek pika 2?

**Naureda Llagami:** Po!

**Brikena Ukperaj:** Në vend të termit “rekrutim” sepse ky nuk është rekrutim, ky është emërim i përkohshëm. Ndhmësit ligjorë do të zgjedhin në vendet që ne kemi të shpallura. Kështu që të zëvendësohet termi “rekrutim” me “emërim i përkohshëm”, pra “procedurat e emërimit të përkohshëm”.

**Naureda Llagami:** Po!

Dakord.

Atëherë, e hedhim në votim, së bashku me sugjerimin e bërë nga zonja Ukperaj.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Shpalljen e 17 vendeve vakante, në pozicionin e Ndhmësit Ligjor, në gjykatat e apelit, si më poshtë:

-Në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Tiranë - 6 ndihmës ligjorë;

-Në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Durrës - 1 ndihmës ligjor;  
-Në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë - 2 ndihmës ligjorë;

-Në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Korçë - 1 ndihmës ligjor;  
-Në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Shkodër - 1 ndihmës ligjor;  
-Në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit Vlorë - 3 ndihmës ligjorë;  
-Në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar - 3 ndihmës ligjorë.

2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për zhvillimin e procedurave të rekrutimit, sipas dispozitave të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohen në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 12 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 20.11.2020)*

**Pika 13 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për ushtrimin e të drejtës së rekursit kundër vendimit nr. 93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit”, përgatitur nga Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
11. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

13. Shqyrtimi i projektvendimit “Për ushtrimin e të drejtës së rekursit kundër vendimit nr. 93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit”, përgatitur nga Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës. Në fakt, sipas radhës i bie që të jetë shorti për caktimin e gjyqtarëve, por përpara se të bëjmë shortin, kalojmë në atë çështje që ne shtuam, që ka të bëjë me ushtrimin e të drejtës së rekursit kundër vendimit nr. 93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Toska, lidhur me projekt-aktin.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për ushtrimin e të drejtës së rekursit kundër vendimit nr. 93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit”. Krahas kësaj është përcjellë edhe relacioni shpjegues lidhur me shkaqet e përgatitjes së këtij projektvendimi.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 07.08.2020, në kuadër të shqyrtimit të projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.84 dhe nr.87, datë 26.02.2020, si dhe Vendimet nr.241, nr.242, nr.243, nr.244 dhe nr.245, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, bazuar në rrethanat e faktit dhe ligjin e zbatueshëm, me Vendimin nr. 268,

ndër të tjera, vendosi: “6. Mospërfshirjen e aplikueses znj. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira në proces”.

Në këtë rast, sikundër edhe në të gjitha rastet e tjera në lidhje me procedurat e kandidimeve për ngritjet në detyrë, Këshilli ka konsideruar se në zbatim të pikës 6, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar: Në procedurat e ngritjes në detyrë në një gjykatë më të lartë ose të specializuar mund të kandidojë çdo gjyqtar që plotëson kriteret ligjore, pavarësisht faktit nëse ka kandiduar në procedura të mëparshme ngritjeje në detyrë; Në çdo rast, kandidati nuk mund të kandidojë në më shumë se tre pozicione të lira që janë në proces, pavarësisht kohës së shpalljes së tyre, qenies së tyre në të njëjtën gjykatë apo në të njëjtën fushë të së drejtës; Në rast të kandidimit në më shumë se tre pozicione të lira në proces, kandidati duhet të rikonsiderojë kandidimet e tij, për të përcaktuar tre pozicionet për të cilat vijon kandidimin. Mospërcaktimi i tyre nga vetë kandidati, passjell identifikimin e vullnetit të tij në bazë të kohës së kandidimeve, duke filluar nga ai i bërë më parë ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, në bazë të radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë; Kandidimi për një pozicion të lirë për të cilin procedura e ngritjes në detyrë është finalizuar/përmbyllur dhe kandidimi i tërhequr, nuk llogariten si kandidime për efekt të të drejtës së kandidimit në jo më shumë se tre pozicione të lira.

Lidhur me kandidaten znj. {...}, Këshilli ka konstatuar se ajo kishte kandiduar në total për 7 (shtatë) pozicione të lira në proces dhe konkretisht për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, si dhe për katër pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, po në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr.241, nr. 242, nr. 243 dhe nr. 244, datë 09.07.2020.

Po ashtu, Këshilli ka mbajtur parasysht se kandidatja znj. {...}, sikundër edhe disa kandidatë të tjerë që kishin kandiduar për ngritjen në detyrë në më shumë se tre pozicione të lira në proces, ndërsa ligji kufizon të drejtën e kandidimit deri në tre të tillë, më datë

04.08.2020, ishte njoftuar dhe ftuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për të rikonsideruar kandidimet e saj, për të përcaktuar tre pozicionet për të cilat do të vijonte kandidimin. Pavarësisht kësaj kandidatja ka zgjedhur të mos i përgjigjej ftesës.

Në një situatë të tillë, Këshilli ka marrë vendimin si më lart.

Kandidatja znj. {...} ka ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit të mësipërm të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Kjo e fundit, me Vendimin nr. 93, datë 10.11.2020, ka vendosur:

“1. Pranimin pjesërisht të padisë së paditëses {...}. 2. Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 286/6 datë 07.08.2020 “Për mospërfshirjen e znj. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. 3. Lejimin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë të paditëses {...} për tre pozicione nga katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas vendimeve nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, duke urdhëruar palën e paditur Këshilli i Lartë Gjyqësor të vijoje procedurat për paditësen për tre pozicione të lira, sipas preferencës së paditëses kandidate, ose në mungesë, sipas renditjes së tyre. 4. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit. ...”.

Më datë 19.11.2020, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar për njoftim Vendimi i arsyetuar nr. 93, datë 10.11.2020, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Sipas vendimit të arsyetuar, Gjykata Administrative e Apelit në rastin konkret, ndërsa as paditësja nuk ka ngritur ndonjë pretendim, nuk ka konstatuar mangësi në procesin e nxjerrjes së vendimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Por, nga ana tjetër, duke konsideruar se kishte juridiksion të plotë rishikues, Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të Këshillit, duke vlerësuar se vendimi ishte i paligjshëm në kuptim të nenit 109, shkronjat “d” dhe “dh”, të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: ...; d) është në kundërshtim me ligjin material; dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; ...”.

Kështu, në vendimin e saj, Gjykata ka arsyetuar se: “... në interpretimin sistematik dhe logjik, vlerëson se, në rastin në gjykim, papranueshmëria e kandidimit të paditëses

me arsyen se, tre kandidimet e mëhershme të paditëses për pozicione të lira të shpallura në një procedurë të mëparshme, janë ende në proces, është e gabuar dhe ka sjellë për pasojë mohimin e të drejtës së kandidimit të paditëses për tre pozicionet e lira për të cilat ka shprehur interes për t'u ngritur në detyrë. Gjykata çmon se kufizimi sipas pikës 6 të nenit 48 vepron në rastin e kandidimit për më shumë se tre pozicione të shpallura në të njëjtën kohë, kur ka shumë pozicione të lira dhe ushtrohet pas shpalljes së procedurës për plotësimin e tyre nga Këshilli, nga e cila ligji përcakton se llogaritet edhe afati maksimal tremujor për plotësimin e pozicioneve të lira të shpallura”.

Sikurse edhe në raste të tjera të ngjashme të mëparshme, kur Gjykata Administrative e Apelit ka disponuar për shfuqizim të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për ushtrimin e të drejtës së rekursit kundër Vendimit nr. 93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit”.

Lidhur me projektvendimin e propozuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka në konsideratë se zbatimi i ligjit nga ana e Këshillit, pikërisht pikës 6, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, është korrekt, duke vlerësuar se Gjykata ka gabuar në zbatimin e ligjit.

Po ashtu, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka në konsideratë se Këshilli ka marrë katër vendime të të njëjtës natyrë, të cilët janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila ka cenuar vetëm një prej tyre, pikërisht Vendimin nr. 286/6, datë 07.08.2020. Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Shërbimeve Juridike, tre vendimet e tjera janë kundërshtuar në Gjykatën e Lartë nga paditësit në ato raste, një prej tyre dhe znj. {...}. Referuar vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit, në mënyrë të qartë evidentohen qëndrime të ndryshme mbi interpretimin dhe zbatimin e ligjit, pikës 6, të nenit 48, të Ligjit për Statusin. Një situatë e tillë krijon problematikë në zbatimin e ligjit në vijim nga Këshilli.

Për sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka vlerësuar se ekzistojnë shkaqe për ankimimin në Gjykatën e Lartë, të Vendimit nr. 93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke iu referuar për këtë Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, pikërisht nenit 58 të tij, ku përcaktohet se:



“Vendimet e shpallura nga Gjykata Administrative e Apelit në rastet që parashikohen në këtë ligj, mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë:

a) për zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, të një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;

b) kur vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika e Kolegjit Administrativ ose e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;

c) ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjykimit.”.

Kemi konsideruar që të përfshihen në shkronjën /a/ të kësaj dispozite shkaqet e ankimit që ne kemi propozuar të ushtrohet ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Të ushtrojë të drejtën e rekursit kundër Vendimit nr. 93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, që i përket paditëses {...}.

2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Juridike për të ndjekur procedurën e përgatitjes dhe të depozimit të rekursit.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 13 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 20.11.2020)*

**Pika 14 e rendit të ditës me objekt:** Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës<sup>1</sup>.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 13:55.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Marçela Shehu** (anëtare)

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 5. Ermira Lleshi, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike & Përafrimit të Legjislacionit.*

#### **RENDI I DITËS:**

14. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje të fundit të rendit të ditës është zoti Ilir Toska.

Në këtë çështje do të shqyrtohen referuar urgjencës së tyre 5 relacione propozuar sipas kësaj radhe për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat; Gjykatën e Apelit Shkodër, Gjykatën e Apelit Vlorë, Gjykatën e Apelit Korçë dhe Gjykatën e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën

e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet Kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, konkretisht: Znj. Esmeralda Xhili (Çeka).

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, që janë caktuar më herët për gjykimin e saj apo që kanë pengesë ligjore, konkretisht: Znj.Saemira Hila, Znj.Ersida Bajgora, për të cilën për këtë të fundit Këshilli më herët vendosi përjashtimet nga shortet për një periudhë 6-mujore.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Arjeta Lika.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër** ka paraqitur nevojë për 6 çështje gjyqësore. Lidhur me trajtimin e tyre konstatohet se për kërkesën e gjashtë (sipas renditjes), Gjykata e Apelit Shkodër më datë 17.11.2020 ka hequr dorë nga kjo kërkesë, ndërsa ka konstatuar se Këshilli më herët më datë 05.11.2020, KLGJ ka caktuar gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Durrës, z. Desart Avdulaj. Nisur nga kjo, referuar neneve 90/3 dhe 94/1 e Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenit 97/3 e Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i propozon Këshillit që të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kësaj kërkesë të Gjykatës së Apelit Shkodër.

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)*

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, sa i përket kërkesave të tjera, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 5 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: Z.Desart Avdulaj.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës që janë caktuar më herët, gjatë vitit 2020, për gjykimin e 15 apo më shumë çështjeve në gjykata të tjera të apelit, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Znj.Izet Dushaj; Znj.Anita Mici; Z.Valbon Çekrezi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 5, gjyqtar Florjan Kalaja.

Për çështjen nr. 2, gjyqtarja Igerta Hysi.

Për çështjen nr. 4, gjyqtar Florjan Kalaja.

Për çështjen nr. 3, gjyqtarja Igerta Hysi.

Për çështjen nr. 1, gjyqtar Florjan Kalaja.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale, me karakter tepër urgjent ose urgjent.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastër që është anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konkretisht: Znj.Miranda Andoni. Ndërsa mos të përjashtohet nga shortizoti Dritan Banushi në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë në Gjykatën e Apelit Gjirokastër.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Enton Dhimitri.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Izet Salaj dhe Dritan Banushi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë civile, me karakter urgjent.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1. Ai të përzgjidhet me short ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilat janë përzgjedhur me shortin e fundit, atë të datës 05.11.2020, për të gjykuar çështje gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë, konkretisht gjyqtarëve Asim Vokshi, Maria Qirjazi dhe Edlira Petri.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, që kanë pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: Znj.Maria Qirjazi; Znj.Edlira Petri.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtari Asim Vokshi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeje gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat me juridiksion të përgjithshëm. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 2, të cilët të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë



në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë që është anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konkretisht: Znj.Miranda Andoni.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarët të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart, të cilët janë caktuar më herët, gjatë vitit 2020, për gjykimin e një apo më shumë çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: Z.Astrit Kalaja; Znj.Anita Mici; Z.Enton Dhimitri; Znj.Irena Brahim; Znj.Margarita Buhali; Z.Ridvan Hado.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, gjyqtarja Edlira Petri.

Për çështjen nr. 1, gjyqtari Dritan Banushi.

Mbyllen të gjitha procedurat e shortit.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

\* \* \*

(Pika 14 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**